

**QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS
TATIMORE DHE DOGANORE**

RAPORT VJETOR 2021

I VEPRIMTARISË

Tiranë




Tabela e Përmbajtjes

QËLLIMI:	2
OBJEKTIVI:	2
PËRMBLEDHJE	2
ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA	5
PROGRAMET E TRAJNIMIT 2021	6
AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE	7
<i>Trajnime të punonjësve të rinj</i>	<i>7</i>
<i>Trajnime të punonjësve vazhdues</i>	<i>17</i>
<i>Trajnime të Nivelit Drejtues.....</i>	<i>34</i>
AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE.....	39
<i>Trajnime të punonjësve të rinj</i>	<i>39</i>
<i>Trajnime të punonjësve vazhdues</i>	<i>49</i>
<i>Trajnime me nivelin drejtues</i>	<i>63</i>
ANEKS I:Tabela me të dhënat vjetore për trajnimet me administratën doganore.....	69
ANEKS II: Tabela me të dhënat vjetore për trajnimet me administratën tatimore.....	80
ANEKS III: Tabelë përmbledhëse për trajnimet me administratën tatimore dhe doganore	88
Vlerësimi i Trajnimeve	90
TRAJNIMI I TRAJNERËVE	92

QËLLIMI:

Arritja e objektivave të institucionit në funksion të zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese, duke i orientuar të trajnuarit në kuptimin e përgjegjësive të tyre teknike, profesionale në zbatim të legjislacionit fiskal.

OBJEKTIVI:

Krijimi i njohurive të reja dhe zgjerimi i njohurive ekzistuese rreth sistemit fiskal dhe ligjor nëpërmjet trajnimeve, duke krijuar mundësinë e shkëmbimit të njohurive mes kategorive të ndryshme të punonjësve të Administratës Tatimore dhe Doganore, aftësimin e tyre praktik dhe teorik.

Organizimi i procesit të edukimit në fushën fiskale duke pasur në fokus arritjen e objektivave strategjike të përgjithshme të qeverisë.

Organizimi i trajnimeve në mënyrë efektive dhe eficiente duke mbajtur një kosto sa më të ulët por duke bërë të mundur zhvillimin cilësor të mësimdhënies.

Orientimi i lektorëve dhe organizimi i workshopeve drejt seminarëve praktike duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit.

PËRMBLEDHJE

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore gjatë vitit 2021 është fokusuar në

- trajnimin fillestar,
- vazhdues dhe
- te nivelit drejtues të administratës tatimore dhe doganore.

Trajnimi ka përfshirë çështje bazë dhe specifike që lidhen me detyrat e ushtruara , dhe ndryshimet ligjore të fushës fiskale

Trajnimi eshte dhene për punonjës të ri , për nivelin vazhdues dhe nivelin drejtues ,në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore

Përzgjedhja e temave të trajnimit u mbështet kryesisht në kërkesat e administratave fiskale, në bazë të identifikimit që ato i bëjnë nevojave për trajnim në tema dhe njerëz, si dhe ne syzjerimet e pjesmarresve dhe te lektoreve .

Në zbatim të Programit të Trajnimeve , te diskutuara dhe te miratuara ne bord janë hartuar Kalendarët e Trajnimeve për sigurimin e duhur të trajnimit profesional të punonjësve të administratës tatimore dhe doganore.

Qendra në bashkëpunim të ngushtë me ekspertet e projektit të BE “Asistencë Teknike për të mbështetur forcimin e kapaciteteve për zbatimin e strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike në Shqipëri' dhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka punuar për dezinjimin e komponenteve të reformës lidhur me kuadrin ligjor, administrativ dhe mësimor të Qendrës.

Në kuadër të reformimit te qendres ne bashkepunim me eskperetet e eprojektit, në vitin 2021, gjatë veprimtarisë së QTATD-së, u hartuan bazat strukturore te dokumentave te meposhtem dhe u diskutuan ato gjeresisht :

DRAFT VKM “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”

DRAFT URDHËR për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”

DRAFT URDHËR Për miratimin e rregullores “Për zhvillimin e trajnimeve nga Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”

Draft URDHËR I KRYEMINISTRIT “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”

DRAFT UDHËZIMI “Për miratimin e masës së pagesës së lektorëve të jashtëm të Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore dhe tarifave të zbatueshme ndaj të trajnuarve jashtë Administrates Tatimore dhe Doganore dhe për përsëritjen e trajnimit”

Qendra së bashku me ekspertët pjesë e projektit të BE, ka punuar për strukturën e programeve specifike të trajnimit duke përfshirë kurrikulat.

Trajneret janë pjesë shumë e rëndësishme e mesimit dhe për këtë qëllim Qendra në bashkëpunim me ekspertet e BE dhe me Ministrinë e Financave ka organizuar trajnimin e trajnerëve lidhur me metodat e reja të mësimdhënies për të rritur.

Qendra i planifikon veprimtaritë e saj bazuar në filozofinë e zhvillimit ose përmirësimit profesional gjatë të punuarit të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me efektivitetin në punë si dhe të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me detyrat e përditshme të vendit të punës.

Inspektorëve të tatimeve dhe doganave ju jepet mundësia e zhvillimit profesional pa pagesë gjatë trajnimeve të përgatitura nga një nivel i lartë profesional lektorësh dhe që varion gjerësisht në lidhje me filozofinë, përmbajtjen dhe formatin e eksperiencave të të mësuarit.

Qendra përdor metodat profesionale të edukimit profesional të tilla si:

Diskutime të rasteve praktike - me qëllim që inspektorët të vihen në rolin e vendim marrësit që përballet me një problem. Çdo seminar është shoqëruar me një hapësirë dedikuar rasteve praktike për ta bërë akoma më të prekshëm çdo problematikë sidomos duke pasur parasysh faktin që Qendra bën trajnimin e punonjësve të rinj të cilët nuk kanë eksperiencë.

Përdorim i trajnerëve nga radhët e metodistëve ose stafit drejtues të organeve fiskale- me qëllim përmirësimin e kompetencave të pjesëmarrësve në një fushë specifike, nëpërmjet demonstrimit të procesit të observimit, reflektimit dhe veprimit.

Diskutim të çështjeve praktike të hasura nga vetë pjesëmarrësit- me qëllim përmirësimin e praktikës profesionale, nëpërmjet angazhimit në ndarjen e çështjeve që shqetësojnë, me njëri tjetrin si dhe mesimit me kolegët me të cilët kanë të njëjtin objektiv për të arritur.

Leksione studimore - me qëllim që të zgjidhen dilemat lidhur me mënyrën e leximit dhe interpretimit të neneve të veçanta të ligjeve fiskale.

Konsultime – për të promovuar ndërgjegjësimin e inspektoreve dhe përpunimin e zhvillimit të tyre profesional nëpërmjet ofrimit dhe rekomandimit të mundësive të strukturuar për reflektim dhe observim.

Mbikqyrje reflektive - për të mbështetur, zhvilluar dhe vlerësuar punën e lektorëve dhe performancën e pjesëmarrësve nëpërmjet një procesi pyetësorësh që inkurajon të kuptuarin dhe artikullimin e të arsyeshmes gjatë mesimdhënies dhe mesimarrjes.

Asistencë teknike - për të ndihmuar individët e organeve fiskale të përmirësohen, nëpërmjet ofrimit të informacioneve dhe burimeve të legjislacionit primar e sekondar, udhëzuesëve e manualeve sipas punës që mbulon secili dhe detyrave në përputhje me punën.

Testime – për të skanuar shkallën e njohurive që zotërojnë, njohurive që marrin dhe për të vlerësuar nevojat e mëtejshme për trajnim specifik.

QTATD është përpjekur të jetë sa më efiçente dhe efektive dhe në këtë kuadër ka përqafuar dhe prirjen e shekullit për rritjen e zhvillimit profesional të kryer online.

Në industrinë e edukimit, përdorimi i mesimeve online të edukimit profesional përfaqëson një përqindje në rritje dhe QTATD sidomos në kohën e COVID 19 e ka përqafuar këtë duke respektuar dhe nevojën për trajnim të një mase më të gjerë profesionistësh që merren me çështjet tatimore dhe doganore

ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA

Orientimi i lektorëve dhe organizimi i workshopeve ka qenë drejt seminarëve praktike duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit.

Janë **trajnuar trajnerët rreth metodave të reja të mësimdhënies për të rritur** që kanë në qendër pjesëmarrësit dhe ku shkolla është instrument në avancimin dhe shpërndarjen e praktikave më të mira.

Janë **trajnuar trajnerët mbi mësimdhënien në platforma online** dhe pjesëmarrësit mbi aksesimin në këto platforma. Nëpërmjet organizimit të trajnimeve online **janë adaptuar** këto forma të reja të mësimdhënies.

PROGRAMET E TRAJNIMIT 2021

Janë hartuar dhe miratuar me Vendimin nr.1 datë 21.01.2021 të Bordit të Qëndres së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, programet e trajnimit si më poshtë:

Administrata tatimore: 4 Programe trajnimi

- Programi i Trajnimit për punonjësit e rinj me 11 Tema,
- Programi i Trajnimit për nivelin drejtues me 6 Tema,
- Programi i Trajnimit për nivelin vazhdues me 17 Tema,
- Programi i Trajnimit për punonjësit e Hetimit Tatimor me 8 Tema.

Administrata doganore: 3 Programe trajnimi

- Programi i Trajnimit për punonjësit e rinj me 10 Tema,
- Programi i Trajnimit për nivelin drejtues me 5 Tema,
- Programi i Trajnimit për nivelin vazhdues me 25 Tema.

Në zbatim të programeve të miratuara janë hartuar kalendarët përkatës dhe përfunduar aktiviteti trajnues.

Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve:

-Koordinohet midis institucioneve në lidhje me pjesëmarrësit në këto trajnime.

-Komunikohet me lektorët në lidhje me metodologjinë që përdoret në trajnimet online si dhe në lidhje me kurrikulat dhe dokumentat shoqërues për secilin trajnim.

-U dërguan kalendarët si edhe një rregullore rreth organizimit të trajnimeve online.

-U zhvilluan seminarët në platformën online Zoom.-U dërguan materialet e trajnimeve për pjesëmarrësit si dhe formularët e vlerësimit online.

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE

Trajnime të punonjësve të rinj

AKTIVITETI I

“Akciza. Garantimi dhe lëvizja e mallrave të akcizës. Pullat fiskale, administrimit dhe monitorimi. Përrjashtimet nga akciza, limitet e pataksueshme në import. Magazinat fiskale, lëvizja në pezullim i mallrave të akcizës.”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove të Administratës Doganore, 34 pjesëmarrës, respektivisht specialiste dhe doganiere C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Njohja me ligjin nr.61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”;
- Garantimi dhe lëvizja e mallrave të akcizës;
- Lëvizja e mallrave nën regjimin e pezullimit të detyrimeve të akcizës;
- Dokumentin Shoqërues Administrativ.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që punonjësit të njihen me konceptet bazë të ligjit mbi akcizat, zbatimin në praktikë, lindjen e detyrimit të akcizës, deklarimin, mallrat të cilat i nënshtrohen akcizës, mallrat të cilat përfitojnë përjashtim nga akciza, në mënyrë që të jenë të saktë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre në përputhje me bazën ligjore.

AKTIVITETI II

“Regjimet doganore. RPA, RLP. Deklarimi, përfaqësimi. Deklarata doganore. Garancitë doganore.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **45 pjesëmarrës**, specialiste dhe doganiere C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Magazinimi i përkohshëm;
- Çlirimi për qarkullim të lirë;
- Regjime të posaçme;
- Eksporti;
- Regjim transiti;
- Regjim magazinimi;
- Regjim përpunimi;
- Përdorim i veçantë.

Objektivi i këtij trajnimi: që punonjësit të njihen me hyrje-daljen e mallrave, deklarinin përmbledhës të hyrjes dhe të daljes, procedurat që ndiqen, magazinimi i përkohshëm, regjimet doganore, regjimet e posaçme, magazinat doganore, zonat e lira, përpunimi aktiv dhe përpunimi pasiv, lejimi i përkohshëm, përdorimi përfundimtar end use.

AKTIVITET III

“TVSH (Çfarë është TVSH, TVSH në import, përjashtimet, skemat e veçanta, vlera e tatueshme, etj). Taksat nacionale. Ligji i procedurave.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom, 50 pjesëmarrës**, respektivisht specialiste dhe doganiere C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Njohja me ligjin Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohja me ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohja me ligjin Nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që punonjësit të njihen me kuptimin e përgjithshëm dhe shpjegime bazë mbi parashikimet ligjore për tvsh, procedurat tatimore, taksat kombëtare, zbatimin e tyre përsa i përketë importeve dhe eksporteve.

AKTIVITET IV

“Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **52 pjesëmarrës**, respektivisht specialist dhe doganier C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Njohja me ligjin nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sanksionon në nenin 20 të tij “Komunikimin e informacioneve si dhe mbrojtjen e dhënave”;
- Njohja me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në Republikën e Shqipërisë;
- Informimi publik, subjektet që kanë të drejt të informohen;
- Vendime gjyqësore të GJEDNJ-së dhe gjykatave shqiptare.

Objektivi i këtij trajnimi: njohja me bazën ligjore përsa i përketë mbrojtjes së të dhënave personale, përcaktimet çfarë quhen të dhëna personale, mbrojtjen e të dhënave personale në raport me informimin publik, mënyrat e informimit publik, me kërkesë dhe pa kërkesë, programet e transparencës, koordinatorët e informacionit.

AKTIVITET V

“Përdorimi i programit ASYCUDA WORLD, SEED, LIMS.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **56 pjesëmarrës**, respektivisht specialist dhe doganier C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Përdorimi i programit Asycuda World;

- Përdorimi i programit SEED;
- Përdorimi i programit Lims.

Objektivi i këtij trajnimi: njohja me përdorimin e programit Asycuda World, programin Seed, programin Lims, procedurat që ndiqen në secilin rast.

AKTIVITET VI

“Cash (Parandalimi i Pastrimit të parave). Lëndët Radioaktive.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **52 pjesëmarrës**, respektivisht specialist dhe doganier C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Ligji nr.9917 datë 19.05.2008, “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.15 datë 16.02.2009 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftës për Financimin e Terrorizmit ne Sistemin Doganor”.
- Udhëzues praktik- Mbi deklarimin e parave cash;
- Manual - Për mënyrën e procedurës së kontrollit në mbështetje të doganierëve për deklarimin e parave cash, çek, metale e gurë të çmuar në Dege/Pika Doganore Kufitare (DDK).

Objektivi i këtij trajnimi: njohja me bazën ligjore për parandalimin e trafikimit të parave cash, armëve, lëndëve narkotike dhe psikotrope, veprave të artit, lëndëve radioaktive, bashkëpunimi që kanë më agjensi kombëtare dhe organizma ndërkombëtare, detyrimi për të deklaruar, kush duhet të deklaroj, vlerat dhe mallrat të cilat duhet të deklarohen, procedura e deklarimit, plotësimi i formularëve të deklarimit, gjobat në rast mosdeklarimi.

AKTIVITET VII

Datë **23 Shkurt 2021**, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave organizoi trajnimin me temë **“Rëndësia e Vlerësimit Doganor të mallrave. Metodat e Vlerësimit Doganor të mallrave.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **54 pjesëmarrës**, respektivisht specialist dhe doganier C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Rëndësia e vlerësimit doganor të mallrave;
- Metodat e vlerësimit;
- Kontrolli i vlerës.

Objektivi i këtij trajnimi: njohja me metodën e vlerës së transaksionit, vlerën e transaksionit të mallrave identikë, vlerën e transaksionit të mallrave të ngjashëm, metodën e vlerës së deduktuar, metodën e vlerës së përlllogaritur, metodën e të dhënave të disponueshme.

AKTIVITET VIII

“Rregullat e Origjinës së mallrave. Marrëveshjet dhe kumulimi. Provat e origjinës.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **52 pjesëmarrës**, respektivisht specialist dhe doganier C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Rregullat e origjinës;
- Origjina preferenciale;
- Origjina jopreferenciale;
- Kumulimin diagonal dhe bilateral;
- Procedurat IDT dhe IDO.

Objektivi i këtij trajnimi: njohja me rregullat e origjinës, origjinën preferenciale dhe jo preferenciale, si përfshihet origjina, statuti i origjinës, marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe protokollet e rregullave të origjinës, produktete origjinuese, lehtësirat, rregullat që zbatohen në këtë rast.

AKTIVITET IX

“Tarifa doganore dhe klasifikimi i mallrave. Përfshirjet nga taksat doganore në import. Informacioni tarifor detyrues dhe trajtimi tarifor favorizues. Taksat e tjera në import dhe eksport të shërbimit doganor.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **50 pjesëmarrës**, respektivisht specialist dhe doganier C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrollave Paszhdoganimit A posteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Klasifikimi Tarifor;
- Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave;

Objektivi i këtij trajnimi: njohja me Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, klasifikimin tarifor mënyrën se si klasifikohen mallrat, kodin 11 shifror, mënyrën se si duhet të procedojë një doganier.

AKTIVITET X

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave organizoi trajnimin me temë **“Borxhi Doganor. Akti administrativ. Shkeljet doganore. Si të bëhet një shkresë.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **52 pjesëmarrës**, respektivisht specialist dhe doganier C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrollave Paszhdoganimit A posteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Borxhi doganor;
- Borxhi i akcizës;
- Debitorët;

- Sekuestrimi preventive dhe konservativ;
- Shlyerja e detyrimeve të papaguara.

Objektivi i këtij trajnimi: njohja me konceptin e borxhit doganor, borxhit të akcizës, detyrimet e papaguara, debitorët, debitorët solidar, deklaruesit, sekuestrimi preventive dhe konservativ, momenti në të cilin lind borxhi doganor, marrja e vendimit, mbajtja e procesverbalit, arsyetimi i vendimit, baza ligjore, kontabilizimi në zëra të veçantë, njoftimi i vendimit, afatet e njoftimit, shlyerja e detyrimeve të papaguara, titulli ekzekutiv, urdhëri ekzekutiv, shuaraja e detyrimeve të papaguara, shkeljet doganore.

AKTIVITET XI

“Kodi i etikës. Konflikti i interesit në administratën doganore shqiptare.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **52 pjesëmarrës**, respektivisht specialist dhe doganier C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Kodi i etikës.
- Konflikti i interesit në administratën doganore shqiptare.

Objektivi i këtij trajnimi: njohja me Kodin e Etikës, zbatimin e saj në administratën doganore, parimet që parashikon ligji, detyrimin për ta zbatuar, disiplinore për shkelje të Kodit të Etikës, raste praktike, mënyra se si është proceduar nga administrata doganore.

AKTIVITET XII

“Trafikimi i veprave të Artit. Mbrojtja e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **49 pjesëmarrës**, respektivisht specialist dhe doganier C1 dhe C2 nga Drejtoria e Kontrolleve Pas zhdoganimit Aposteriori, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standarteve Profesionale, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Teknike e Akcizës, Degët Doganore.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Trafikimit i veprave të Artit.
- Mbrojtja e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale.
- Shkeljet sipas Kodit Doganor dhe Kodit Penal.

Objektivi i këtij trajnimi : njohja me misionin e drejtorisë së antitrafikut për parandalimin e trafikimit të veprave të artit, bashkëpunimi që kanë më agjensi kombëtare dhe organizma ndërkombëtare, trafikimin e trashigimisë kulturore dhe veprave të artit, shkeljet sipas Kodit Doganor dhe Kodit Penal në lidhje me mosdeklarimin. Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale, patentat dhe modelet e përdorimit; disenjot industriale; markat tregtare dhe të shërbimit; treguesit gjeografikë; qarqet e integruar.

Foto nga Trajnimet Online me punonjësit e rinj të administratës doganore:



Përkufizime të përgjithshme

- Në këtë ligj dhe në aktet të tjera nënligjore, në zbatim të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 1. "Administratë doganore" janë strukturat qendrore dhe vendore të Shërbimit Doganor Shqiptar që në zbatim të kompetencave të tyre, janë të ngarkuara me administrimin e akcizës.
 2. "Akciiza" është një taksë që zbotohet mbi produktet e akcizës, të prodhuara dhe të importuara, që liden për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 3. "Produkte që i nënshtrohen akcizës" janë:
 - a) produktet energjetike;
 - b) alkoolit dhe pijet alkoolike;
 - c) duhanit e produktet e duhanit;
 - d) produktet e tjera, të përcaktuara nga ky ligj.
 4. "Depozimesi i miratuar" është një parim fiskal, i autorizuar nga autoritetet doganore në ushtrimin e aktivitetit të tij për të prodhuar, përpunuar, mbajtur, pritur ose dërguar produkte që i nënshtrohen akcizës nën regjimin e përcaktuar në këtë ligj.
 5. "Regjimi doganor përmirësues" është një nga procedurat apo regjimet e parashikuara në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë, që ka të bëjë me mbajtjen doganore të mallrave jo shpërndarë gjatë futes së tyre në territorin doganor shqiptar, në magazinimin e përkohshëm, në zonat e lirisë ose magazinat e lirisë ose në një nga regjimet e parashikuara në këtë Kod.

DOGANA CUSTOMS

Kilohi Shqiptare

15

Testim me punonjësit e rinj

Në përfundim të programit të trajnimit për punonjësit e rinj në periudhë prove të administratës doganore, **Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore** organizoi testimin mbi vlerësimin e njohurive të fituara nga pjesëmarrësit.



Foto nga Testimi



AKTIVITETE TRAJNUESE

PUNONJËS VAZHDUES TË ADMINISTRATËS DOGANORE

AKTIVITET XIII

“Akciza. Trajnim për kontrollet dokumentare dhe në subjekt akcize për mallrat e akcizës. Mbikqyrja e subjekteve të regjimeve dhe akcizës. Mallrat e akcizës dhe llogaritja e kësaj takse për këto produkte. Plotësimi i DSHA-së.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, 15 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Kontrollet dokumentare
- Mbikqyrja e subjekteve
- Plotësimi i DSHA-së

Gjatë trajnimit u diskutua për financat publike, funksioni ekonomik i shtetit, përkufizimi sipas tre pikëpamjeve, tatimet dhe taksat.

Në vijim të diskutimit trajneri u ndal në mënyrë të zgjeruar te akciza, konceptet bazë, produktet të cilat i nënshtrohen akcizës, kontrollet në fushën e akcizës, objekti i kontrollit, analiza e riskut, indikatorët, llojet e verifikimeve, dokumentacioni, rikontrolli, rastet në të cilat kryhet, raporti, administrimi i dokumentacionit.

AKTIVITET XIV

“Vlerësimet e punonjësve. Komisioni Disiplinor. Ngritja në detyrë dhe karriera në Shërbimin Civil.” dhe “Përshkrimet e punës dhe monitorimi i performancës.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, 27 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Vlerësimi i punës
- Vlerësimi i njohurive shtesë
- Shkeljet disiplinore
- Ngritja në detyrë
- Përshkrimet e punës

Gjatë trajnimit u diskutua ligji për nëpunësin civil, vlerësimet e punës, personat kompetent për kryerjen e vlerësimit për secilën kategori, zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues, vlerësimi i rezultateve, tre fazat e vlerësimit, nivelet e vlerësimit, efektet e vlerësimit të rezultateve, ankimi, vlerësimi i njohurive shtesë.

Në vijim të trajnimit u diskutua disiplina në shërbimin civil, shkeljet disiplinore, procedimi disiplinor, procedura që ndiqet, përbërja e grupit disiplinor, shuarja e masave disiplinore.

Gjithashtu u trajtua ngritja në detyrë, aplikimi, verifikimi paraprak, vlerësimi i kandidatëve.

AKTIVITET XV

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave organizoi trajnimin me temë **“Procedurat e mostrimit. Procedura e marrjes së mostrave laboratorike. Kompetencat e laboratorëve testues dhe kalibrues (Për Standartin 17025:2017). Metodatat e reja analitike për analizimin e mallrave dhe njohjen e praktikave me të mira laboratorike.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, 10 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Procedurat e mostrimit
- Kompetencat e laboratorëve
- Standarti 17025:2017

Gjatë trajnimit u diskutua mbi procedurat e mostrimit, udhëzimin dhe manualin, procedura që ndiqet në marrjen e mostrave, parimet e përgjithshme, metodat e marrjes së mostrave, mjetet e

marrjes së mostrave, procesverbalet, procedurat e mostrimit, transportimit, ruajtjes së mostrave, administrimit të rezultateve të analizave laboratorike.

Gjithashtu u trajtuan shembuj nga marrja e mostrave për lloje të ndryshme mallrash, instrumentet që përdoren dhe procedura që ndiqet për mallin konkret.

AKTIVITET XVI

“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë. Ndryshimet në Kodin Doganor”.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, 22 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Parimet strategjike
- Parimet e përgjithshme
- Ndryshimet në Kodin Doganor
- Shkeljet në fushën doganore, sanksionet dhe ankimimi

Gjatë trajnimit u diskutuan parimet bazë të Kodit Doganor, fusha e zbatimit, misioni, përafrimi dhe harmonizimi me standartet e BE-së që sjell si detyrim MSA-ja.

Në vijim të diskutimit trajneri u ndal në mënyrë të zgjeruar te parimet strategjike, parandalimi, zbulimi, hetimi dhe procedimi, analiza e riskut, përdorimi i asistencës administrative dypalëshe, aplikimin e një mjedisi doganor pa letra, risit e Kodit të ri Doganor.

AKTIVITET XVII

“Hyrja-Dalja e mallrave, ndryshimet në legjislacion dhe në Asycuda. Politikat e Vlerësimit Doganor. Statusi i mallrave.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, 29 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Koncepti i hyrjes së mallrave;
- Proçesin e mbërritjes së mallrave;
- Çfarë është paraqitja e mallrave;
- Koncepti i magazinimit të përkohshëm;
- Depozitimi i deklaratës përmbledhese të hyrjes;
- Mbërritja e mallrave;
- Paraqitja e mallrave;
- Vendosja e mallrave nën procedurën e magazinimit të përkohshëm.

Gjatë trajnimit u diskutua mbi deklarin e mallrave, deklarimin përmbledhës (para nisjes, para mbërritjes), deklarimin në magazinim të përkohshëm, deklarimin e plotë.

Në vijim të trajnimit u diskutua lëvizja e mallrave, hapat të cilat ndiqen duke përfshirë depozitimin e deklaratës përmbledhese të hyrjes, mbërritjen e mallrave, paraqitjen e mallrave, vendosjen e mallrave nën procedurën e magazinimit të përkohshëm, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar secilën prej tyre.

Gjithashtu u diskutua mbi regjimet doganore, regjim transiti, regjim magazinimi, regjim përpunimi, përdorim i veçantë, shoqëruar me raste praktike. Në pjesën e fundit u trajtuan zhvillimet e reja duke u ndalur tek nënshkrimi elektronik, DEMP, deklarimi i thjeshtuar, zhdoganimi lokal, vlerësimi në qendër.

AKTIVITET XVIII

“Operacionet e privileguara. Dispozita.Përrjashtimet nga detyrimet doganore. Bashkëbisedim në lidhje me rastet e përrjashtimit të mallrave nga pagesat doganore. Raste praktike dhe kazuse në lidhje me pagesën e detyrimeve doganore.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, 18 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Operacionet e privileguara;
- Përrjashtimet nga pagesa e TVSH-së;
- Informacione detyruese;
- Procedura IDT dhe IDO.

Gjatë trajnimit u diskutua mbi operacionet e privileguara, kushtet e përgjithshme, kushtet e veçanta, procedura që ndiqet, aplikimi për IDT dhe IDO, anulimi, amendimi, revokimi, pavlefshmëria, e drejta e apelimit.

AKTIVITET XIX

“Regjimet ekonomike (Përpunim Aktiv-Pasiv) RPA, RLP.Zonat e lira doganore.”

Trajnimi u zhvillua në platformën, me 41 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Hyrja-dalja e mallrave
- Magazinimi i përkohshëm
- Regjimet e posaçme
- Transiti
- Zonat e lira
- Eksporti

Gjatë trajnimit u diskutua për hyrje-daljen e mallrave, deklarimin përmbledhës të hyrjes dhe të daljes, procedurat që ndiqen. Në vijim të diskutimit trajneri u ndal në mënyrë të zgjeruar te magazinimi i përkohshëm, regjimet doganore, regjimet e posaçme, magazinat doganore, zonat e lira, përpunimi aktiv dhe përpunimi pasiv, lejimi i përkohshëm, përdorimi përfundimtar end use.

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive ku përveç anës teorike u diskutuan edhe raste konkrete nga zbatimi në praktikë si dhe u drejtuan shumë pyetje nga pjesëmarrësit të cilat kishin të bënin me rastet praktike që pjesëmarrësit hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre poredhe me vendimet dhe udhëzimet e dala së fundmi.

AKTIVITET XX

“Origjina preferenciale e mallrave. Korelimet vjetore. Trajtimet tarifore favorizuese.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **23 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Rregullat e origjinës preferenciale dhe origjinës jopreferenciale;
- Marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe protokollet e rregullave të origjinës;
- Korelimet vjetore;
- Trajtimet tarifore favorizuese.

Gjatë trajnimit u diskutua origjina preferenciale, rregullat tranzitore, rregullat e reja, kumulimi, konventa nderkomëtare, marrëveshjet e reja, detyrimet e shtetit shqiptar, diskutim i rasteve praktike.

AKTIVITET XXI

“Vlerësimi doganor, metodat e vlerësimit.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me **23 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Vlera doganore
- Metodatat e vlerësimit

Gjatë trajnimit u diskutua vlera doganore, metodatat e vlerësimit, pasojat nga vlerësimet e gabuara, raste praktike për diskutim.

AKTIVITET XXII

“Kodi i Etikës dhe konflikti i interesit në administratën doganore shqiptare. Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **12 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Kodi i Etikës;
- Mbrojtja e të dhënave personale;
- Njohja me ligjin nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sanksionon në nenin 20 të tij “Komunikimin e informacioneve si dhe mbrojtjen e dhënave”;
- Njohja me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në Republikën e Shqipërisë;
- Informimi publik, subjektet që kanë të drejt të informohen;
- Vendime gjyqësore të GJEDNJ-së dhe gjykatave shqiptare.

Objektivi i këtij trajnimi ishte diskutimi mbi Kodin e Etikës, zbatimin e tij në administratën doganore, parimet që parashikon ligji, detyrimin për ta zbatuar, masat disiplinore për shkelje të Kodit të Etikës, raste praktike, mënyra se si është proceduar nga administrata doganore. Gjithashtu u diskutua mbi bazën ligjore përsa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, përcaktimet çfarë quhen të dhëna personale, mbrojtjen e të dhënave personale në raport me informimin publik, mënyrat e informimit publik, me kërkesë dhe pa kërkesë, programet e transparencës, koordinatorët e informacionit.

AKTIVITET XXIII

“Konventa e Rishikuar Pan-Euro-Mesdhetare PEM. Marreveshja CEFTA dhe Kumulimi Diagonal SAP dhe SAP+”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, trajnimi, **30 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Përpunim i plotë/prodhimi
- Punimi apo përpunimi i mjaftueshëm
- Rregulli i Tolerances
- Kumulimi i origjinës
- Ndarja e llogarive
- Territorialiteti
- Rregulli i mosmanipulimit

- Kthimi i detyrimeve doganore - Draëback
- Provat e origjines si dhe Deklaratat e Furnitorit

Gjatë trajnimit u diskutuan rregullat e origjinës në zonen pan-Euro-Mesdhetare, situata e Shqipërisë, rregullat tranzitore të origjinës, rregulla të reja të origjinës duke përfshirë aspektin procedural.

AKTIVITET XXIV

“Shkeljet në fushën e doganore. Kundërvajtja dhe kontrabanda. Kundërvajtjet në fushën doganore, kazuse. Kontrabanda, kuptimi i veprës penale të kontrabandës, elementet e veprës së kontrabandës, zgjidhja administrative. Dispozita penale për kontrabandën. Padia civile në procesin penal, zgjidhja administrative e kontrabandës. Raste praktike dhe zgjidhje e kazuseve për shkeljet doganore.”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **23 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Kundërvajtja administrative dhe kontrabanda. Kundërvajtjet administrative në fushën doganore.
- Kontrabanda, kuptimi i veprës penale të kontrabandës, elementet e veprës së kontrabandës.
- Zgjidhja administrative e kontrabandës.
- Padia civile në procesin penal.

Gjatë trajnimit u diskutua ndarja e shkeljeve doganore në kundërvajtje administrative dhe kontrabandë. Zgjidhja administrative e kontrabandës si rast përjashtimor. Raste praktike për diskutim.

AKTIVITET XXV

“Kodi Doganor dhe Kodi i Procedurave Administrative. Kundërvajtjet administrative. Ankimi administrativ, format e ankimit administrativ ndaj akteve të administratës doganore dhe kushtëzimet ligjore. Apelimet. Aktet dhe veprimet administrative të favorshme”.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me **17 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Kundravajtjet administrative.
- Ankimi administrativ, format e ankimit administrativ ndaj akteve të administratës doganore dhe kushtëzimet ligjore.
- Apelimet.
- Aktet dhe veprimet administrative të favorshme.

Gjatë trajnimit u diskutua vendimet e favorshme në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor dhe ankimimi, vendimi administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit dhe ankimi ndaj tij, ankimi në zbatim të kodit doganor për rastet e vlerësimit doganor, risitë e kodit doganor.

AKTIVITET XXVI

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë "**Legjislacion dhe Institucione Europiane. Marrëveshjet kryesore ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera.**"

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me 48 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Konceptet kryesore të legjislacionit doganor në Evropë;
- Përafrimet ligjore të ndërmarra nga shteti shqiptar si pjesë e rekomandimeve nga institucionet evropiane;
- Marrëveshjet e nënshkruara nga shteti shqiptar me shtetet e tjera, si ato dypalëshe dhe ato në të cilat nënshkruet janë më shumë se dy shtete;
- Pikat e përbashkëta mes legjislacionit doganor shqiptar dhe atij evropian;
- Dallimet ndërmjet legjislacionit doganor shqiptar dhe atij evropian.

Gjatë trajnimit u diskutua për konceptet kryesore në legjislacionin doganor shqiptar dhe atë evropian. Në vijim të diskutimit trajneri u ndal në mënyrë të zgjeruar marrëveshjet e shtetit

shqiptar, kryesisht në ato dypalëshe për të bërë një krahasim mes marrëveshjeve të ndryshme dhe detyrimeve të shtetit shqiptar për zbatimin e tyre.

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive ku përveç anës teorike u diskutuan edhe raste konkrete nga zbatimi në praktikë si dhe u drejtuan shumë pyetje nga pjesëmarrësit të cilat kishin të bënin me rastet praktike që pjesëmarrësit hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, por edhe me vendimet dhe udhëzimet e dala së fundmi.

AKTIVITET XXVII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë **“Klasifikimet tarifore dhe Nomenklatura e kombinuar e mallrave. ITMS.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me 19 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli posteriori, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave
- Nomenklaturën e Sistemit të Harmonizuar (SH) të Organizatës Botërore të Doganave;
- Nënndarjet, që i janë bërë nomenklaturës së SH-së, të quajtura ndryshe edhe “nënkrerë të NKMve”, të cilave u përgjigjet një nivel i caktuar i taksës doganore;
- Dispozitat paraprake, shënimet shtesë për seksionet, kapitujt dhe shënimet fundore për nënkrerët e NKM-ve.
- Tarifën doganore/nivele të ndryshme taksash sipas llojit të mallrave
- Mbledhjen e statistikave të tregtisë ndërkombëtare.
- Rregullat e Origjinës.

Gjatë trajnimit u diskutua për mënyrën e ndarjes së kategorive të mallrave që hyjnë e dalin në doganë. Gjithashtu trajneri u fokusua edhe tek ligjet e aktet nënligjore në të cilat mbështetet klasifikimi i mallrave. Po ashtu u krahasua edhe ndarja që Shqipëria ka për mallrat

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive ku përveç anës teorike u diskutuan edhe raste konkrete nga zbatimi në praktikë si dhe u drejtuan shumë pyetje nga pjesëmarrësit të cilat kishin të bënin me rastet praktike që pjesëmarrësit hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, por edhe me vendimet dhe udhëzimet e dala së fundmi.

AKTIVITET XXVIII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë **“Trajnim për kontrollin pas çdoganimit aposteriori (teori dhe kontroll praktik).”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **45 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Objektivi i kontrollit pas zhdoganimit;
- Fazat e kontrollit aposterior;
- Tipet e Kontrolleve;
- Vendimmarrja;
- Administrimi i dokumentacioni;

Gjatë trajnimit u planifikimi i kontrollit (bazuar në indiciet kryhet përgatitja dhe organizimi i procedurave të kontrollit), zhvillimi i kontrollit (tërësia e proceseve gjatë kryerjes së kontrollit), raporti kontrollit, (analizat, aktet e prodhuara nga grupi i kontrollit, vlerësimi i raportit perfundimtar), benefitet e kontrollit pas zhdoganimit, kontrolli për zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe, elementët e procesverbalit, raste nga praktika.

AKTIVITET XXIX

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë **“Kontrolli Doganor. Kontrolli i mallrave dhe mbikqyrja doganore. Kontrolli aposterior.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **40 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Prezantimi i koncepteve bazë: territor, zonë, zyrë doganore, detyrime importi, detyrime eksporti, mbikqyrje doganore;

- Marrja në pyetje, dëgjimi vëzhgimi;
- Vlerësimi i Riskut;
- Kontrolli i mallrave;
- Metodatat e vlerësimit & inkotemat.

Gjatë trajnimit u trajtua kontrolli doganor, kontrolli i mallrave, mbikqyrja doganore, kontrolli aposterior. Gjithashtu u trajtuan metodatat e vlerësimit duke shpjeguar në mënyrë të detajuar metodën e vlerës së transaksionit, metoda e mallrave identike dhe të ngjashme, metodën e deduksionit, metodën e vlerës së përlllogaritur, metodën në bazë të dhënave të disponueshme.

AKTIVITET XXX

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë **“Thellim në nomenklaturën e mallrave dhe notat shpjeguese lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me **38 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

Çështjet kryesore

- Rregullat e klasifikimit
- Nota shpjeguese të HS
- Nota shpjeguese të CN (NK)
- Rregullore klasifikimi (BE), udhëzime
- Klasifikimi i përbashkët

Gjatë trajnimit u trajtua tarifa doganore, nivele të ndryshme taksash sipas llojit të mallrave, rregullat e klasifikimit, ndërtimi i nomenklaturës së kombinuar, parimi i taksimit, reduktimet tarifore, informacioni tarifor detyrues, trajtimi tarifor favorizues, nota shpjeguese të HS, nota shpjeguese të CN (NK), raste praktike për diskutim.

AKTIVITET XXXI

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore organizoi trajnimin me temë **“Auditimi në sistemin doganor.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **38 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet specialist, inspektor, përgjegjës, jurist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Organizimi i NJAB-së në DPD
- Çfare duhet të zotërojë stafi Auditues
- Misioni i Drejtorisë së Auditimit të brendshëm
- Roli i Auditit të brendshëm
- Subjektet që auditohen
- Plani Vjetor
- Fokusi i rekomandimeve

AKTIVITET XXXII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë ***“Metodologjia e krijimit dhe vlerësimit të profileve të riskut”***

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Ana ligjore të menaxhimit të riskut;
- Temat kryesorë që hasen në këtë fushë;
- Organizimin e strukturës së menaxhimit të riskut;
- Rrethi mësimor dhe vlerësimi i rrezikut;
- Analizën dhe vlerësimin e riskut;
- Hapat për zhvillimin e një profili risku;
- Selektimi i SAD (IM/EX)

Gjatë trajnimit trajneri u fokusua në përshkrimin e anën ligjore të menaxhimit të riskut, termat kryesorë që hasen në këtë fushë, organizimin e strukturës së menaxhimit të riskut, rrethi mësimor dhe vlerësimi i rrezikut, analizën dhe vlerësimin e riskut, hapat për zhvillimin e një profili risku, selektimi i SAD (IM/EX).

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive ku përveç anës teorike u diskutuan edhe raste konkrete nga zbatimi në praktikë si dhe u drejtuan shumë pyetje nga pjesëmarrësit të cilat kishin të bënin me rastet praktike që pjesëmarrësit hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, por edhe me vendimet dhe udhëzimet e dala së fundmi.

AKTIVITET XXXIII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë **“Borxhi doganor. Fazat e lindjes dhe shuarjes të borxhit doganor. Titulli ekzekutiv dhe ekzekutimi i tij nëpërmjet masave detyruese si sekuestrimi dhe konfiskimi; praktika administrative dhe gjyqësore në lidhje me rikuperimin forcërisht të borxhit doganor. Vendimet e favorshme në lidhje me përjashtimin doganor. Raste praktike dhe kazuse në lidhje me lindjen, pagesën e detyrimeve doganore, shuarjen, rimbursimin dhe parashkrimin.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **22 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, jurist borxhi, përgjegjës i mbikqyrjes doganore, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Borxhi doganor.
- Fazat e lindjes dhe shuarjes të borxhit doganor.
- Titulli ekzekutiv dhe ekzekutimi i tij nëpërmjet masave detyruese si sekuestrimi dhe konfiskimi; praktika administrative dhe gjyqësore në lidhje me rikuperimin forcërisht të borxhit doganor.
- Vendimet e favorshme në lidhje me përjashtimin doganor.
- Raste praktike dhe kazuse në lidhje me lindjen, pagesën e detyrimeve doganore, shuarjen, rimbursimin dhe parashkrimin.

AKTIVITET XXXIV

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë **“Procedurat doganore. Dispozita të zbatueshme për mallrat që hyjnë dhe dalin nga dhe në territorin doganor. Operatori ekonomik i autorizuar. Përfaqësimi. Dokumentet e përfaqësimit. Praktika doganore. Raste praktike.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me 25 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Mënyra e deklarimit para hyrjes së mallrave;
- Deklarimi përmbledhës i hyrjes;
- Deklarimi përmbledhës i daljes;
- Mënyra e magazinimit të përkohshëm;
- Regjimet doganore/ regjimet e posaçmë;
- Transiti i jashtëm/ transiti i brendshëm;
- Zonat e lira;
- Përpunimi aktiv.

Gjati trajnimit pati një shpalosje të legjilacionit të procedurave doganore në momentin kur mallrat hyjnë e dalin nga doganat shqiptare. Në këtë kuadër, u trajnuan pjesëmarrësit në lidhje me mënyrën sesi ata duhet të procedojnë në varësi të kategorive të ndryshme të mallrave që hyjnë e dalin në territor. Po ashtu u trajtuan edhe regjimet doganore, duke përfshirë regjimet e posaçme apo edhe shpjegimin konceptual e teorik të zonave të lira dhe kuptimit të operatorëve ekonomikë të autorizuar.

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive ku përveç anës teorike u diskutuan edhe raste konkrete nga zbatimi në praktikë si dhe u drejtuan shumë pyetje nga pjesëmarrësit të cilat kishin të bënin me rastet praktike që pjesëmarrësit hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, por edhe me vendimet dhe udhëzimet e dala së fundmi.

AKTIVITET XXXV

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë **“Trajnim për Ligjin 92/2014 “Për TVSH në RSH”. Procesi i përfrimit me legjislacionin e BE-së (direktiva 2006/112/EC)”**.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet doganier nga zyra e mbikqyrjes doganore, doganier nga kontrolli aposteriori, specialist.

ÇËSHTJET KRYESORE



- Ligji 92/2014 për TVSH;

- Historik i ligjeve për TVSH;
- Subjektet që preken nga ligji për TVSH;
- Mbi cilat parime është ndërtuar ligji;
- Roli i punonjësve të doganave në zbatimin e ligjit;
- Përafrimi i legjislacionit shqiptar me BE, në këtë fushë përkatëse.

Gjati trajnimit u shpalos dhe u zbërthye nga trajneri ligji për TVSH në Republikën e Shqipërisë, sipas kapitujve kryesorë të tij. Po ashtu u trajtuan edhe problematikat e hasura gjatë zbatimit të ligjit, për shkak ose të mos njohjes së ligjit ose të interpretimit gabim të tij. Njëkohësisht u trajtua edhe përafrimi i legjilacionit shqiptar me atë evropian në kuadër të reformave për procesin e aderimit në BE.

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive ku përveç anës teorike u diskutuan edhe raste konkrete nga zbatimi në praktikë si dhe u drejtuan shumë pyetje nga pjesëmarrësit të cilat kishin të bënin me rastet praktike që pjesëmarrësit hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, por edhe me vendimet dhe udhëzimet e dala së fundmi.

Foto nga Trajnimet Online me punonjësit e nivelit vazhdues të administrates doganore:



AKTIVITETE TRAJNUESE

Trajnime të Nivelit Drejtues

AKTIVITET XXXVI

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore organizoi trajnimin me temë **“Parimet e përgjithshme të Kodit Doganor. Raste praktike.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, **15 pjesëmarrës**, respektivisht nga drejtoria e buxhetit dhe financës, drejtoria e vlerësimit në qendër, drejtoria e auditimit të brendshëm, drejtoria e antikontrabandës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Parimet strategjike.
- Parimet e përgjithshme
- Risit e Kodit të Ri

Gjithashtu gjatë trajnimit u trajtua parimi i kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave, përdorimi i asistencës administrative dypalëshe për të siguruar mirëfunksionimin e legjislacionit doganor, parandalimi, zbulimi, hetimi dhe procedimi për mashtrimet dhe shkeljet e legjislacionit doganor

AKTIVITET XXXVII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore organizoi trajnimin me temë **“Taksimi (Sistemi fiskal, TVSH, Taksat nacionale, Ligji i procedurave tatimore). Raste praktike dhe gjyqësore, ndryshimet ligjore.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me **18 pjesëmarrës**, respektivisht nga drejtoria e buxhetit dhe financës, drejtoria e vlerësimit në qendër, drejtoria e auditimit të brendshëm, drejtoria e antikontrabandës.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Procedurat tatimore
- Tatim mbi vlerën e shtuar

- Tatim mbi të ardhurat
- Taksat kombëtare
- Taksat vendore
- Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndtësore
- Lojrat e fatit ,kazinot dhe hipodromet
- Fiskalizimi

Kjo temë trajnimi ka për qëllim trajtimin e sistemit fiskal në Republikën e Shqipërisë, duke u ndalur në mënyrë të detajuar te ligji për TVSH, ligji për taksat nacionale, ligji i procedurave tatimore. Gjithashtu trajtimin e rasteve praktike gjyqësore.

AKTIVITET XXXVIII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë **“Menaxhimi Strategjik, Taktik, Operacional i riskut; roli i analizës së riskut dhë rëndësia e kontrollit doganor tregtar.”**

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me 17 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet drejtuese të administratës doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Mënyrën e deklarimit para hyrjes së mallrave;
- Identifikimi i riskut;
- Rrethi i vlerësimit të riskut;
- Burimet e informacionit (të hapura, të mbyllura, kombëtare, ndërkombëtare);
- Identifikimi i riskut në pikat kufitare;
- Kategoritë e menaxhimit të riskut

Gjatë trajnimit trajneri u fokusua në përshkrimin e anën ligjore të menaxhimit të riskut, termat kryesorë që hasen në këtë fushë, por edhe mënyrën se si identifikohet risku, kryesisht në pikat kufitare. Po ashtu trajneri tregoi edhe disa nga kategoritë për menaxhimin e riskut dhe cilat procedurat më të mira për tu ndjekur në momentin që evidentohet risku.

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive ku përveç anës teorike u diskutuan edhe raste konkrete nga zbatimi në praktikë si dhe u drejtuan shumë pyetje nga pjesëmarrësit të cilat kishin të bënin me rastet praktike që pjesëmarrësit hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, por edhe me vendimet dhe udhëzimet e dala së fundmi.

AKTIVITET XXXIX

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë "*Masat antikorrupsion dhe sjellja e duhur e punonjësve të administratës doganore.*"

Qëllimi i këtij trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me këtë fushë, për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Grupi pjesëmarrës përbëhet nga punonjës drejtues të administratës doganore që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre punojnë sipas procedurave specifike doganore, ku u diskutua mbi mënyrat e shmangjes së korrupsionit në sektorin doganor. Po ashtu u dhanë shembuj nga shtetet e tjera, rreth mënyrave sesi ata e kishin luftuar korrupsionin doganor. Po ashtu u trajtuan edhe mënyrat më efektive të bashkëpunimit ndërinstitucional për një ulje deri në zero të korrupsionit në administratën doganore.

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit zgjeruan njohuritë e tyre lidhur me mekanizmat kryesorë dhe me efektive në sulmimin e korrupsionit në dogana.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Si është luftuar korrupsioni doganor në vendet e zhvilluara;
- Cilat janë praktikat më të mira;
- Bashkëpunimet ndërshtetërore në këtë fushë;
- Ndryshimet në legjislacionin shqiptar në kuadër të luftës së korrupsionit në fushën doganore.

Trajnimi ishte interaktiv, me shembuj konkret të fushës përkatëse.

Trajnimi u realizua online, në platformën Zoom, me **pjesëmarrës 19 punonjës** drejtues të administratës doganore.

AKTIVITET XXXX

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë "**Çështjet gjyqësore në fushën e doganave. Veprat penale në fushën doganore. Diskutim, raste praktike.**"

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me pjesëmarrës punonjës të nivelit drejtues të administrates doganore.



ÇËSH TJET KRYESORE

- Cilat janë çështjet gjyqësore në fushën doganore;
- Cila prej çështjeve ka edhe vepër penale brenda saj;

Gjatë trajnimit trajneri u fokusua në përshkrimin e çështjeve gjyqësore më të shpeshta në sistemin doganor, duke u fokusuar jo vetëm në çështjet administrative, por edhe në ato procese të cilat përfshijnë në brendinë e tyre edhe vepra penale. Po ashtu mes pjesëmarrësve u diskutuan edhe raste praktike, me të cilat ata janë njohur gjatë veprimtarisë së tyre të punës.

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive ku përveç anës teorike u diskutuan edhe raste konkrete nga zbatimi në praktikë si dhe u drejtuan shumë pyetje nga pjesëmarrësit të cilat kishin të bënin me rastet praktike që pjesëmarrësit hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Foto nga trajnimet me nivelin drejtues-dogana



AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE

Trajnime të punonjësve të rinj

AKTIVITETI I

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve organizoi trajnimin me temë **“Administrata Tatimore Shqiptare, Organizimi, Funkzioni, Marrëdhëniet e punës, Kodi i Etikës dhe Shmangie e Konfliktit të Interesit, Procedurat e Vlerësimit të Performancës dhe Procedimi Disiplinor”**.

Trajnimi është programuar në Programin e Trajnimeve për vitin 2021, të miratuar me Vendimin e Bordit të QTATD Nr.1 datë 21.01.2021 dhe të planifikuara në buxhetin vjetor të institucionit dhe se bashku me 10 tema të tjera është pjesë përbërëse e Programit për punonjësit e rinj në periudhë prove të administratës tatimore.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me 50 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE:

- Administrata Tatimore Shqiptare
- Administrata Tatimore Qendrore
- Baza legjislative, objekti, funksionet dhe parimet e organizimit
- Struktura dhe organigrama
- Punësimi dhe marrëdhëniet e punës
- Vlerësimi i punës
- Procedimi disiplinor
- Kodi i etikës dhe shmangia e konfliktit të interesit

Objektivi i këtij trajnimi është që punonjësit tatimorë të njohin detyrimin ligjor për respektimin e kërkesave të punës për realizimin e detyrave funksionale në nivel individual dhe grupi, arritjen e objektivave personale dhe në nivel grupi për të ndikuar pozitivisht në objektivin e përgjithshëm mbledhjen e të ardhurave tatimore, respektimin e dispozitave ligjore të parashikuara për ushtrimin e detyrës.

AKTIVITETI II

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë **“Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë - Parimet e Administrimit Tatimor”**.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Dispozita të Përgjithshme
- Parimet e organizimit dhe Personeli Administratës Tatimore
- Dispozita Administrative të Përgjithshme
- Të drejtat e Tatim Paguesit (TP)
- Detyrimi TP për regjistrim
- Mbajtja e kontabilitetit për qëllime tatimore
- Deklarata Tatimore
- Vlerësimi Tatimor
- Pagesa dhe Rimbursimi I tatimit
- Kontrolli Tatimor
- Mbledhja me force e detyrimit tatimor
- Hetimi Tatimor
- Ankimimi Administrativ
- Sanksionet

Gjatë kohëzgjatjes së trajnimit, u prezantua ana teorike e leksionit mbi procedurat tatimore, filluar që nga objekti dhe fusha e veprimit të ligjit dhe deri tek secili kapitull i vecantë. Ky trajnim u zhvillua me ndërveprim midis pjesëmarrësve, duke drejtuar pyetje herë pjesëmarrësit lektorit e herë lektori pjesëmarrësve dhe me trajtimin e rasteve praktike për ta kuptuar më qartë.

AKTIVITET III

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë **“Tatimi mbi të Ardhurat - Njohuritë të Përgjithshme (TAP-BV), (Tatimi mbi fitimin, Marrëveshjet Ndërkombëtare). Sistemi i**

Taksave në Republikën e Shqipërisë - Taksat Kombëtare dhe Taksat Lokale, Lojërat e Fatit, Kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore”.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Tatimi mbi të Ardhurat - Njohuritë të Përgjithshme (TAP-BV)
- (Tatimi mbi fitimin , Marrëveshjet Ndërkombëtare)
- Sistemi i Taksave në Republikën e Shqipërisë - Taksat Kombëtare dhe Taksat Lokale
- Lojërat e Fatit
- Kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore

Gjatë këtij trajnimi u diskutuan aspektet kryesore bazë, për të krijuar një panoramë të përgjithshme të përcaktimeve kryesore që ligji bën, e pjesa tjetër e trajnimit, u zhvillua duke trajtuar raste praktike në formën e kazuseve të cilat duheshin zgjidhur nga pjesëmarrësit.

AKTIVITET IV

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë ***“Bazat e tatimit mbi vlerën e shtuar - kuptimi i përgjithshëm dhe shpjegime bazë për njohjen e ligjit përkatës”.***

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me 50 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua aspekti teorik i ligjit, objekti dhe karakteristikat e TVSH-së, personat e tatueshëm, transaksionet e tatueshme, vendin e furnizimit të transaksioneve të tatueshme, lindjen e tatimit, kërkueshmërinë, vlerën e tatueshme, shkallën tatimore, përjashtimet, furnizimet me shkallë zero, eksportet, lindjen dhe aplikimin e së drejtës së zbritjes, detyrimet e personave të tatueshëm dhe të disa personave jo të tatueshëm, regjimet e veçanta.

AKTIVITET V

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë **“Kontabiliteti”**.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Koncepte e nocione të përgjithshme mbi të ardhurat.
- Të ardhurat e ushtrimit në sektorin publik, përmbajtja, klasifikimi dhe struktura.
- Trajtimi i evidencës kontabël të të ardhurave.

Dy momente të rëndësishme rreth trajnimit ishin Trajtimi i përmbajtjes dhe evidencës kontabile të llogarive të klasës 7 “Llogaritë e të ardhurave të ushtrimit” dhe trajtimi i përmbajtjes dhe evidencës kontabile të llogarive të klasës 4 “Llogaritë e marrëdhënieve me të tretë”.

Rreth trajnimit të përmbajtjes dhe evidencës kontabile të llogarive të klasës 4 “Llogaritë e marrëdhënieve me të tretë”, çështjet kryesore që u trajtuan përfshijnë koncepte të përgjithshme për të drejtat e detyrimit, llogaritë e debitoreve të ndryshëm, llogaritë e kreditorëve të ndryshëm, llogaritë e marrëdhënieve me shtetin.

Ky trajnim u zhvillua me ndërveprim midis pjesëmarrësve, duke drejtuar pyetje herë pjesëmarrësit lektorit e herë lektori pjesëmarrësve dhe me trajtimin e rasteve praktike për ta kuptuar më qartë.

Në përmbyllje të trajnimit u diskutua Funkcionimi i llogarive të klasës 5, i cili u pasqyrua gjithashtu në mënyre skematike, si edhe transferimet dhe rezultati në sektorin publik.

AKTIVITET VI

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë **“Manuali i Punës për Shërbimin e Tatimpaguesve, Apelimi Tatimor, Avokati i Tatimpaguesve”**.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Të drejtat e tatimpaguesve
- Udhëzimet teknike
- Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin
- Dhënia e informacionit tatimor nga administrata tatimore
- Konfidencialiteti
- Informimi i publikut
- Detyrimi i tatimpaguesit
- Struktura e manualit të shërbimit dhe edukimit

Gjatë pjesës së parë trajnimit u trajtua Manuali i Shërbimit Per Tatimpaguesit, kush do e përdorë këtë manual, çfarë është shërbimi për tatimpaguesit, synimet, objektivat, vlerat, të drejtat themelore të tatimpaguesit sipas ligjit të procedurave, karta e tatimpaguesit, funksioni, detyrat dhe përgjegjësia. U diskutua mbi Sektorin e Shërbimit në DRT, rolin e punonjësve të Sektorit të Shërbimit, veprimet operationale të drejtuesit të Sektorit të Shërbimit në DRT, raportimi në DPT, objekti i veprimtarisë dhe drejtimit kryesore të punës për Sektorin e Shërbimit në DRT.

Në pjesën e dytë u trajtua Shërbimi Ndaj Tatimpaguesit, të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit, shërbimet që ofrohen për tatimpaguesit, nga administrata tatimore, regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të ndryshuara të tatimpaguesit, procesin dhe procedurën e regjistrimit të TP, ndryshimin e të dhënave të regjistrimit, ndryshimin e përgjegjësive tatimore, kalimin në regjistrin në Pasiv të TP, Riaktivizimin e TP nga Pasiv ne Aktiv, Transferimin e TP nga një DRT në një tjetër.

AKTIVITET VII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë ***“Njohuri bazë mbi ligjin për fiskalizimin. Ligji për Faturën dhe Monitorimin e Qarkullimit, procedurat në funksion të saj”***.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Historiku i ligjit;
- Objekti i ligjit, fusha e veprimit dhe qëllimi;
- Risi;
- Elementët ligjorë dhe teknikë të ligjit;
- Tatimpaguesit që lëshojnë faturë;
- Elementët e faturës tatimore dhe llojet e saj;
- Fatura;
- Procedura e Fiskalizimit;

Gjithashtu gjatë këtij trajnim, u analizuan parimet, rregullat, kriteret, afatet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit dhe prodhuesit e mirëmbajtësit e zgjidhjeve softuare-ike, lidhur me lëshimin e faturës; faturën shoqëruese dhe faturën elektronike; përmbajtjen e faturave; regjistrimin e të dhënave dhe procedurën e fiskalizimit të lëshimit të faturave; marrjen e informacionit të pagesave; certifikimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

AKTIVITET VIII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë “*Manuali Porcedurial për Mbledhjen me Forcë (Borxhit Tatimor)*”.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Kush quhet detyrim tatimor i papaguar.
- Misioni i Drejtorisë së mbledhjes së detyrimeve të papaguar.
- Struktura organizative e mbledhjes së detyrimeve tatimore.
- Menaxhimi i çështjeve në sistemin cats.
- Procedura e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara.

Gajtë këtij trajnimi u diskutua gjithashtu mbi lijin e procedurave tatimore, manualin e mbledhjes me forcë, raste nga praktika.

AKTIVITET IX

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë “**Sistemi C@TS**”.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Ndryshimet ligjore të nevojshme për implementimin e sistemit të ri
- Ndryshimet në procedura tatimore
- Ndryshime në strukturën e Administratës Tatimore
- Konsultimi me grupet e interesit (Tatimpaguesit, Bankat, Institucione shtetërore, këshilli tatimor, kontabiliste etj)
- Hartimi ose rishikimi i mareveshjeve të komunikimit me palët e treta
- Krijimi i komiteteve për të marrë vendime
- Informimi dhe përgatitja e tatimpaguesve për sistemin e ri
- Trainimet
- Për tatimpaguesit
- Për administratën

Gjithashtu gjatë këtij trajnim, u analizuan funksionalitetet kryesore në e-filing si deklarimi dhe ndryshimi i deklaratave (14 lloje tatimesh), deklarimi i listepagesave, shtimi dhe largimi i punonjësve, deklarimi për librat e shitjes dhe blerjes, të dhënat e kontabilitetit të tatimpaguesve, urdhërat e pagesave dhe llogaritja e detyrimeve në kohë reale, ngarkimi i bilanceve vjetore, menaxhimi i përdoruesve (përfaqësuesit), menaxhimi i çështjeve (kërkesat nga tatimpaguesit).

AKTIVITET X

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë “**Njohuri të Përgjithshme për Hetimin Tatimor. Mashtrimet dhe evazioni fiskal në fushën e tatimeve**”

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSH TJET KRYESORE

- Mashtrime në fushën e tatimeve
- Evazioni fiskal
- Raste praktike

Gjatë trajnimit përpara se të trajtohet hetimi tatimor, fillimisht është e nevojshme të sillen vëmendje se cilët subjekte, kanë atributet e hetimit.

U trajtua ndërthurja e hetimit në fushën e tatim taksave ndërmjet dy ose tre subjekteve e konkretisht ndërmjet organeve tatimore, organeve të ushtrimit të ndjekjes penale si prokuroria dhe policisë së shtetit.

Lektorja para se të analizonte veprat penale të parashikuara në fushën fiskale, vlerësoi se është e nevojshme të kemi një parashtrim të përmbledhur të kuadrit të legjislacionit tatimor, me qëllim kuptimin e të ardhurave, taksave dhe tatimeve, rolin e organeve ligjzbatuese e në këtë mënyrë të arrijmë të kuptojmë se kur shkeljet e këtyre ligjeve, ngrihen në nivelin e veprave penale.

AKTIVITET XI

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë ***“Manuali i Punës për Kontrollin Tatimor - Procedurat e Kontrollit Tatimor dhe të Verifikimit”***.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSH TJET KRYESORE



- Manuali i punës për kontrollin tatimor
- Procedurat e kontrollit tatimor

Gjatë trajnimit u diskutua mbi kontrollin tatimor, procedura që ndiqet, të drejtat e tatimpaguesit, problematiqet që hasen, raste praktike.

Testim për punonjësit e rinj

Në përfundim të programit të trajnimit për punonjësit e rinj në periudhë prove të administratës tatimore, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore organizoi testimin mbi vlerësimin e njohurive të fituara nga pjesëmarrësit. Në mbështetje të masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së COVID 19, testimi u zhvillua i ndarë në 3 grupe. Pjesëmarrës në testim ishin 48 punonjës të cilët zhvilluan testimin sipas grupeve përkatëse.

Foto nga Testimi



AKTIVITETE TRAJNUESE

PUNONJËS VAZHDUES TË ADMINISTRATËS TATIMORE

AKTIVITET XII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë “*Sistemi tatimor -Procedurat tatimore I*”.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, sipas programimit në kalendarin e trajnimit,, me 32 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë, inspektorë kontrolli, inspektorë nga zyra, përgjegjës sektori të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Kontrolli tatimor në përmbushje të planit strategjik nga AT dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kontrollit tatimor
- Analiza e riskut për përcaktimin e objektit
- Njoftimi i kontrollit tatimor
- Përjashtimi i inspektorit nga kontrolli tatimor
- Raporti i kontrollit tatimor
- Rikontrolli tatimor
- Struktura e manualit të kontrollit

Gjatë trajnimit u diskutua mbi procedurat që ndiqen gjatë kontrollit tatimor, problematikat që hasen, analiza e riskut, të drejtat e tatimpaguesit gjatë kontrollit, raporti i kontrollit dhe raporti i rikontrollit, raste nga praktika.

AKTIVITET XIII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë “*Sistemi tatimor-Procedurat tatimore II*”.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, sipas programimit në kalendarin e trajnimit, në total 6 orë trajnimi, me 61 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë

të parë dhe të dytë, inspektorë kontrolli, inspektorë nga zyra, përgjegjës sektori të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Vlerësimi tatimor
- Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor
- E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor
- E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi
- Letërkujtesa
- Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor
- Baza e mënyrave alternative të vlerësimit
- E drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore
- Manuali për kontrollin nga zyra

Gjatë trajnimit u diskutua gjithashtu mbi raste praktike dhe problematika që punonjësit hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

AKTIVITET XIV

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë “*Sistemi Tatimor-Procedura Tatimore III*”.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, sipas programimit në kalendarin e trajnimit me 49 pjesëmarrës, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë, inspektorë kontrolli, inspektorë nga zyra, përgjegjës sektori të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Kush quhet detyrim tatimor i papaguar.
- Misioni i Drejtorisë së mbledhjes së detyrimeve të papaguar
- Struktura organizative e mbledhjes së detyrimeve tatimore.
- Menaxhimi i çështjeve në sistemin cats.
- Procedura e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara

- Manuali për kontrollin nga zyra.

Gjatë trajnimit u diskutua gjithashtu çfarë quhet detyrim tatimor i papaguar, shkaqet që çojnë në mos pagim, menaxhimi i çështjeve në sistemin Cats, procedurat e mbledhje së detyrimeve tatimore të papaguara, vlerësimi i riskut, masat që merren, ankimimi, sekuestrimi, konfiskimi, shitja në ankand.

AKTIVITET XV

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë ***“Tatimet indirekte-TVSH”***

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë, inspektorë kontrolli, inspektorë nga zyra, përgjegjës sektori të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Objekti
- Persona e tatueshëm
- Furnizim malli
- Furnizim shërbimi
- Detyrimet e personave të tatueshëm

Gjatë trajnimit u diskutua mbi fushën e zbatimit, objekti, kush janë personat e tatueshëm, furnizimi i mallit, furnizimi i shërbimeve, vendi i furnizimit, shembuj praktik për të bërë dallimin kur kemi të bëjmë me furnizim malli dhe kur furnizim shërbimi.

Në vijim të trajnimit u diskutua lindja dhe kërkueshmëria e tatimit, vlera e tatueshme, zbritëshmëria e TVSH-së, kufizimet e së drejtës së zbritjes, ushtrime nga raste praktike.

AKTIVITET XVI

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë ***“Ndryshimet në legjislacionin tatimor. Paketa Fiskale”***

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë, inspektorë kontrolli, inspektorë nga zyra, përgjegjës sektori të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Ndryshimet në legjislacion
- Përjashtimet nga TVSH
- Mbajtja e të dhënave
- Tatimi mbi të ardhurat
- Taksat kombëtare

Gjatë trajnimit u diskutua mbi harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në vendin tonë lidhur me faturimin, me përcaktimet e projektligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, i cili sjell një risi në procesin e faturimit dhe monitorimit të transaksioneve.

Në vijim u diskutua mbi përjashtimin nga TVSH, kufiri minimal i regjistrimit, rimbursimi i TVSH dhe kompesimi i detyrimeve tatimore, rastet, procedurat dhe kriteret për pagesën me këste të TVSH-së së miratuar për rimbursim.

Në pjesën e fundit të trajnimit u trajtuan ndryshimet konkrete në bazën ligjore, risitë dhe efektet në zbatim.

AKTIVITET XVII

, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë ***“Tatimet indirekte: TVSH. Lindja e tatimit, kërkueshmëria. Vlera e tatueshme. Shkalla tatimore. Përjashtimet, furnizimet me shkallë zero, eksportet. Detyrimet e personave të tatueshëm dhe të disa personave jo të tatueshëm”***

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë, inspektorë kontrolli, inspektorë nga zyra, përgjegjës sektori të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Lindja e tatimit, kërkueshmëria.
- Vlera e tatueshme.
- Shkalla tatimore.
- Përjashtimet, furnizimet me shkallë zero, eksportet.
- Detyrimet e personave të tatueshëm dhe të disa personave jo të tatueshëm

Gjatë trajnimit u diskutua lindja e tatimit të dyfishtë, baza ligjore, shkalla tatimore, përjashtimet nga TVSH, furnizimet me shkallë zero, pagesa e Tvsh-së gjatë eksportit të mallrave, trajtimi i rasteve praktike, detyrimet e personave të tatueshme dhe të disa personave jo të tatueshëm.

AKTIVITET XVIII

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, organizoi trajnimin me temë ***“Regjime të Veçanta. Regjimi i bizneseve të vogla. Regjimi për agjencitë e udhëtimit. Regjim i veçantë i zbatuar për shitjen e mallrave të përdorura, veprave të artit, objekteve të koleksionit dhe antikuaret. Regjimi i shitjeve me ankand. Skema e kompensimit të prodhuesve bujqësorë”***

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me **80 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë, inspektorë kontrolli, inspektorë nga zyra, përgjegjës sektori të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Regjimi bizneseve të vogla;
- Regjimi për agjencitë e udhëtimit;
- Regjim i veçantë i zbatuar për shitjen e mallrave të përdorura, veprave të artit, objekteve të koleksionit dhe antikuaret;
- Regjimi shitjeve në ankand;
- Skema e kompensimit të prodhuesve bujqësor.

Gjatë trajnimit u diskutua regjimi i bizneseve të vogla, veprimtaritë për të cilat nuk aplikohet regjimi, e drejta e zgjedhjes, kalimi i kufirit minimal të regjistrimit, dokumentimi.

Gjithashtu gjatë trajnimit u diskutua mbi regjimin për agjencitë e udhëtimit, rastet kur zbatohet ky regjim, transaksionet, llogaritja e TVSH-së, diskutimi i rasteve praktike.

AKTIVITET XIX

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, organizoi trajnimin me temë **“Kontrolli i TVSH. Në sektorin e ndërtimit. Në sektorin e tregtisë. Në sektorin e turizmit”**.

Trajnimi u zhvillua në platformën online **Zoom**, me **31 pjesëmarrës**, respektivisht në pozicionet specialistë, juristë, inspektorë të parë dhe të dytë, inspektorë kontrolli, inspektorë nga zyra, përgjegjës sektori të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore.

ÇËSHTJET KRYESORE

- Kontrolli i TVSH-së në sektorin e ndërtimit.
- Kontrolli i TVSH-së në sektorin e tregtisë.
- Kontrolli i TVSH-së në sektorin e turizmit.

